



Datë: 10.11.2025
Numër Protokolli: 7306/2025

A.nr.1800/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1800/2025, të datës 15.10.2025, të parashtruar nga ankuesi B.R nga Obiliqi, kundër organit të punësimit: Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.1800/2025, e datës 15.10.2025, e parashtruar nga ankuesi B.R.
- II. Obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Obiliqit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke përsëritur kërkesën tek Thesari i Kosovës për kompensim e mjeteve materiale për ankuesin.
- III. Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, që në pajtim me kërkesën e pranuar nga Komuna e Obiliqit të bëjë kompensimin e mjeteve materiale për ankuesin.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi B.R (*tutje referuar ankuesi*), më datë 15.10.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar më numër protokolli:6800/2025, nën shenjë 1800/2025, lidhur me mos ekzekutimin e pagesës retroaktive më shumë prej 4,702.01€ të njohur sipas Vendimit të datës 03.04.2025 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave,

me datën 15.10.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Obiliqit, ndërsa kjo e fundit me datë 22.10.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6800/2025 të datës 15.10.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 12.04.2019 të Kryetarit të Komunës; Përgjigjen e datës 27.06.2025 të Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 19.09.2025 me korrespondencën e bashkangjitur; Kopjen e ID-së së ankuesit; Vendimin e datës 12.04.2018 të Kryetarit të Komunës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 15.10.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 22.10.2025; Akt Emërimit të ankuesit të datës 13.09.2019; Vendimin e datës 12.04.2025 të Kryetarit të Komunës Kërkesën e ankuesit të datës 24.05.2025; Përgjigjen e datës 27.06.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; E-mailin e datës 01.04.2025 dërguar nga A.M për ankuesin më korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; Vendimin e Kryetarit të Komunës i datës 03.04.2025; Formularin e pagesës retroaktive të datës 07.04.2025; E-mailin e datës 30.05.2025; Formularin e pagesës retroaktive të datës 09.07.2025; E-mailin e datës 15.09.2025 dërguar nga Thesari për Komunën e Obiliqit me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 18.09.2025b dërguar nga A.M për Thesarin e Kosovës.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës të dorëzuara nga palët në këtë procedurë administrative, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi është i punësuar në Komunën e Obiliqit, sipas Aktit të Emërimit Nr.2/25 të datës 13.09.2019 në pozitën “Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm”, ndërsa paraprakisht gjatë periudhës kohore nga data 16.03.2018 kishte qenë ushtrues Detyre i Drejtorit të Auditimit të Brendshëm, sipas Vendimit Nr.II-293 të datës 12.04.2018 të Kryetarit të Komunës.

Tutje, sipas kërkesës së ankuesit, Kryetari i Komunës së Obiliqit me datë 03.04.2025 ka nxjerrë vendimin Nr.02-110-03-8951/25 përmes të cilit ia ka njohur të drejtën në kompensim retroaktiv për kohën sa ka qenë duke e ushtruar detyrën e Drejtorit të Auditimit të Brendshëm, për periudhën kohore nga data 16.03.2018 e deri me datë 13.09.2019 në vlerën prej 4,702.01€uro, kurse njësia e Burimeve Njerëzore i ka përcjellë formularin për kompensim retroaktiv në Thesar të paktën edhe dy herë të tjera paraprakisht, sipas formularëve për pagesa të datës 09.07.2024 dhe datës 07.04.2025 , mirëpo ankuesi nuk e ka pranuar kompensimin e njohur nga organi i punësimit.

Së fundmi, organi i punësimit, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Obiliqit me datë 10.09.2025 i është drejtuar Thesarit të Kosovës për kompensimin në formë retroaktive, ndërsa Thesari i Kosovës me datë 15.09.2025 iu ka kthyer përgjigjen se, sa i përket pagesa retroaktive keni tejkalim të mjeteve në kategorinë paga dhe mëditje, kurse Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 18.09.2025 iu kthen përgjigje Thesarit të Kosovës se lidhur me pagesën në formë retroaktive për ankuesin, shumë në vlerën 4,702.01€uro është e bazuar në buxhetin për paga dhe mëditje të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, përcaktuar sipas kodit buxhetor:10-614-16084-0112 “Auditor i Brendshëm”, ndërsa ankuesin e njofton me datë 19.09.2025 lidhur me qëndrimin e thesarit.

Ankuesi, për shkak të mos ekzekutimit të kompensimit material sipas konfirmimit dhe përcaktimit nga organi i punësimit, me datë 15.10.2025 ka parashtruar ankesë në Këshill me pretendimin ankimor se nuk është duke u ekzekutuar vendimi i organit të punësimit lidhur me të drejtën e njohur për kompensim retroaktiv nga Kryetari i Komunës sipas Vendimit të datës 03.04.2025 në vlerën prej 4,702.01€uro, për kohën sa i njëjti ka qenë ushtrues detyre i Drejtorit të Auditimit të Brendshëm.

Thënë si më lartë, pas konstatimit të dhënë si më lartë në arsyetimin këtij vendimi, lidhur me rrethanat juridike të krijuara, analizoi dhe mori përbazë dispozitat e aplikuara nga nenin 8 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“1. Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunëses/it civil, nëpunëses/it të shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë partiake dhe mos diskriminimit”,* ndërlidhur me nenin 22 nga i njëjti ligj, Kolegji i Këshillit konstatoi se nëpunësi civil gëzon të drejtën e pagës për orët e kryera në punë, çështje të tilla, ngjashëm i ka rregulluar edhe legjislacioni i aplikuar në kohë, duke marrë për bazë vendimin e organit të punësimit përkatësisht Zyrtarit Kryesor Administrativë në këtë rast Kryetarit të Komunës së Obiliqit i cili i ka aprovuar kompensimin në formë retroaktive të shumës përkatëse, andaj mbi bazën e këtij vendimi ankesa e ankuesit është aprovuar si në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se duke u bazuar në obligimet ligjore të cekura si më lartë dhe obligimeve të dala nga vendimet përfundimtare, atëherë Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit, është e obliguar që sipas dispozitivit të këtij vendimin, ta përsërisë kërkesën për kompensim për pagat e papaguara për ankuesin të adresoj në Thesarin e Kosovës, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës krahas nenit 97 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është i obliguar që në pajtim me vendimin e cekur më lartë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të marrë parasysh kërkesën e Komunës së Obiliqit me qëllim të zbatimit të saj dhe kompensimit të pagave për ankuesin.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1800/2025, datë 10/11/2025

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit B.R;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;
- Komunës së Obiliqit (Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore) si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK- së.